



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Rev.nr.195/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Beshir Islami dhe Zenel Leku anëtarë, në çështjen juridike të paditësve A.Z. dhe I. Z. nga fshati ..., Komuna e V., të cilët me autorizim i përfaqëson avokati Blerim Sylja nga P., kundër të paditurve Komuna e O., të cilën e përfaqëson avokati Nazmi Mehmeti nga P., dhe Republika e Kosovës – Ministria e Infrastrukturës në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, përkatësisht, Nazmije Aliu, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur lidhur me revizionin e paditësve paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.4301/20 datë 15.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 13.05. 2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i themeltë revizioni i paditësve, prishet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.4301/2020 datë 15.01.2024, ndërsa, lënda i kthehet Gjykatës së Apelit të Kosovës në rivendosje.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4301/2020 datë 15.01.2024 është refuzuar si e pathemeltë ankesa e të paditurës Republika e Kosovës – Ministria e Infrastrukturës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.454/14 datë 17.12.2018, me të cilin, me pjesën e I të dispozitivit të tij, aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve për shpërblimin e dëmit të pësuar në aksidentin e dt.19.12.2013 dhe detyrohet e paditura

Republika e Kosovës – Ministria e Infrastrukturës në Prishtinë të paguaj si vijën: Ia). Paditësit A. Z., për dhimbje fizike shumë prej 900-euro, për frikë 500-euro, për ushqim të përforcuar 30-euro, për kujdesin e personit tjetër 60-euro. Ib). Paditësit I. Z., për dhimbje fizike shumë prej 850-euro, për frikë 500-euro, për ushqim të përforcuar 42-euro, për kujdesin e personit tjetër 85-euro, për automjet “Opell Astra”, me targa ..., në shumë prej 1944-euro. Me pjesën e II të dispozitivit të tij, obligohet e paditura Republika e Kosovës – Ministria e Infrastrukturës të paguajë për shumat e gjykuara, kamatën në lartësi prej 8% nga dita e marrjes së aktgjykimit, si dhe shpenzimet e procedurës shumë prej 1.550,00euro, të gjitha në afat prej 15 ditëve dhe me pjesën e III të dispozitivit, refuzohet kërkesëpadia e paditësve mbi shumat e gjykuara nga paragrafi 1, sikundër refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia ndaj të paditurit, Komuna e Obiliqit.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor, kanë paraqitur revizion paditësit, për shkak të, siç thuhet në të, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, lartësisë së kompensimit, me vërejtjen se kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, përfaqësuesi i paditësve ka paraqitur ankesë, por, gjykata e shkallës së dytë, (Gjykata e Apelit e Kosovës), ankesën e paditësve nuk e ka shqyrtuar fare, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë revizionin si të bazuar dhe ta anulojë aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.4301/2020 dt.15.01.2024 dhe të aprovohet kërkesëpadia e paditësve sipas precizimit të dt. 29.11.2018.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK-së, si dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion , gjeti se:

Revizioni i paditësve është i themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit më datën 11.02.2014, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurve të lartë cekur, për shkak të kompensimit të dëmit , me të dhënat tjera si në petitumin e padisë, precizimit të saj, përkatësisht, si në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallës së parë, lidhur me aksidentin e komunikacionit që ka ndodhur më dt.19.12.2013, lëndimeve të pësuar të paditësve, dëmin material të shkaktuar, lartësinë e kërkesë padisë etj, ka administruar provat përkatëse si ekspertizën e ekspertit të komunikacionit Y. K., të dt.15.06.2017, raportit të QKUK-së të dt.19.12.2013, dokumentacionet mjekësore për të dy paditësit, procesverbalit mbi dëmtimin e automjetit të

dt.15.01.2014, shikimit të fotove, faturave dt.23.01.2014, 23.02.2014, dhe dt.23.01.2014, kontratës së lidhur midis Komunës së Obiliqit dhe NN “Sh.” për mirëmbajtjen e rrugëve, dt.3.01.2014, ekspertizës për vlerësimin e dëmit në automjet të ekspertit N. Sh., dt.29.07.2017, dëgjimit të dëshmitarit B. G., ekspertizës së ekspertëve mjekësor dr.B. I., ortoped dhe traumatolog dhe dr.N. M., psikiatër. Nga provat e administruara ka vërtetuar se paditësit kanë pësuar lëndime të lehta trupore, paditësi i parë, shtypje të kokës dhe shtypje të unazave të qafës, paditësi i dytë, ka pësuar lëndime trupore shtypje dhe përdredhje të qafës, shtypje të koshit të kraharorit. Paditësit kanë pasur dhimbje fizike, frikë, të llojit, të intensitetit, të kohëzgjatjes, si dhe me të dhënat tjera, të përshkruara në mënyrë detaje si në ekspertizat e ekspertëve mjekësor të sipër përmendur, që gjenden në shkresat e lëndës. Po ashtu, nëpërmjet ekspertizës përkatëse, ka vërtetuar dëmin material në automjetin e sipër cekur, në vlerë prej 1.944,00 euro.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes dhe nga provat e administruara, Gjykata e shkallës së parë, ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve dhe ka vendosur si në pjesën I II dhe III të dispozitivit të aktgjyimit të sajë.

Në procedurën ankimore gjykata e shkallës së dytë në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, ndaj, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës Republika e Kosovës – Ministria e Infrastrukturës, në Prishtinë, dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, mirëpo, e njëjta, nuk ka vendosur edhe përkitazi me ankesën e paditësve të paraqitur kundër aktgjyimit të sipër përmendur të gjykatës së shkallës së parë.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, aktualisht nuk mund të pranojë një përfundim të tillë juridik të gjykatës së shkallës së dytë si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, aktgjykimi i sipër cekur i gjykatës së shkallës së dytë, është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 214 përkatësisht, nenit 182.2 pika n), lidhur me nenin 194 dhe nenin 204 të LPK-së, prandaj, për këtë shkak aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë u dashtë të priset dhe lënda t’i kthehet të njëjtës në rivendosje.

Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore qëndrojnë në faktin se Gjykata e Apelit e Kosovës, sikundër rezulton nga shkresat e lëndës, përkitazi me ankesën e dt.1.11.2019, të paraqitur nga paditësit, kundër aktgjyimit të gjykatës së shkallës së parë

C.nr.454/14 dt.17.12.2018, fare nuk ka vendosur, e njëjta ka vendosur vetëm lidhur me ankesën e të paditurës Republika e Kosovës – Ministria e Infrastrukturës në Prishtinë, dhe ka marrë aktgjykimin e lartë cekur. Pra, në shkresat e lëndës, gjendet ankesa e sipër përmendur, e paraqitur nga paditësit, kundër aktgjyimit të gjykatës së shkallës së parë, dhe veç kësaj, paditësit, lidhur me këtë çështje, i kanë drejtuar gjykatës së shkallës së dytë edhe parashtrësën e dt.19.03.2024, e cila po ashtu gjendet në shkresat e lëndës. Paditësit, edhe në pretendimet e veta të revizionit, kanë theksuar shprehimisht, në faqen e dytë të revizionit, nën “ Vërejtje: se kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.454/14 dt.17.12.2018, përfaqësuesi i paditësve ka paraqitur ankesë brenda afatit ligjor, por Gjykata e Apelit të Kosovës, ankesën e paditësve nuk e ka shqyrtuar fare ”.

Nga këtu dhe për arsyet e theksuara më lartë, Gjykata Supreme e Kosovës i ka vlerësuar si të bazuara thëniet e revizionit, që kanë të bëjnë me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të përcaktuara me dispozitat e sipër cekura të LPK-së.

Në rivendosje gjykata e shkallës së dytë duhet të evitohet shkeljet thelbësore të sipër përmendura, të vendos edhe përkitazi me ankesën e palës paditëse, t'i vlerësojë të gjitha thëniet ankimore, si dhe faktet me rëndësi relevante për gjykimin e kësaj çështje juridike, dhe më pas të merr vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Në bazë të asaj që u sipër theksua e në mbështetje të dispozitës së nenit 223.1 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr.195/2024 datë 13.05. 2024

Kryetar i kolegjit,
Mr.sc. Muhamet Rexha

